Kronikë

Sekuestrohen 3 armë zjarri dhe sasi eksplozive në kallëpe në Vlorë, arrestohet 57-vjeçari! I mbante për llogari të grupeve kriminale (EMRI)

Sipas policisë, nga hetimet rezulton se armët dhe lëndë eksplozive dyshohen se mbaheshin të fshehura nga 57-vjeçari për llogari të grupeve kriminale.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gjenerohu

Sh.com Redaksia
20 Mars, 10:43 | Përditësimi: 20 Mars, 11:52

Share

Një 57-vjeçar në Vlorë është arrestuar për armëmbajtje pa leje dhe posedim të lëndëve eksplozive në kuadër të operacionit "Explosion". Në pranga është vënë Xhevahir Sinanaj, pasi gjatë një kontrolli në banesën e tij në fshatin Gorrisht të Selenicës, policia gjeti 3 armë zjarri dhe sasi eksplozivi e ndarë në 10 kallëpe.

Sipas policisë, nga hetimet rezulton se armët dhe lëndë eksplozive dyshohen se mbaheshin të fshehura nga 57-vjeçari për llogari të grupeve kriminale, me qëllim përdorimin në aktivitete të paligjshme.

Njoftimi i policisë:

Sh.com

LEXO EDHE:
Kandidatja e parë e komunitetit rom në listat e PS në Vlorë, Ina Majko: Historike, kandidoj në kushte të barabarta! Partia ka marrë risk

Finalizohet nga Sektori për Hetimin e Krimeve të Rëndа dhe Seksioni për Mbështetjen Operacionale të Hetimit në DVP Vlorë, operacioni policor i koduar "Explosion".

Falë inteligjencës policore dhe ndërhyrjes operacionale, bëhet e mundur sekuestrimi i 3 armëve zjarri dhe një sasie lëndë eksplozive plastike të ndarë në 10 kallëpe.

Vihet në pranga një 57-vjeçar, i cili posedonte dhe mbante të fshehura armët dhe eksplozivin, dyshohet për llogari të grupeve kriminale.

Bazuar në të dhënat e siguruara nga inteligjenca policore, shërbimet e specializuara të DVP Vlorë, organizuan dhe finalizuan me sukses operacioninin policor të koduar "Explosion", duke goditur një rast të armëmbajtjes pa leje dhe posedimit të lëndëve eksplozive.

Gjatë operacionit, në fshatin Gorrisht, Selenicë, lagjja Rexhepaj, u arrestua në flagrancë shtetasi Xh. S., 57 vjeç, banues në këtë zonë.

Gjatë kontrollit të ushtruar pranë banesës së tij, u gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale:

- 3 armë zjarri, të fshehura në një çantë.
- Një sasi lëndë eksplozive plastike, e ndarë në 10 kallëpe, gati për përdorim.

Nga hetimet rezulton se këto armë dhe lëndë eksplozive plastike dyshohen se mbaheshin të fshehura nga 57-vjeçari për llogari të grupeve kriminale, me qëllim përdorimin në aktivitete të paligjshme.

Nën drejtimin e Prokurorisë, vijojnë hetimet për të identifikuar personat e tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Xh.D/r.k./Shqiptarja.com

TAG: Vlorë Xhevair Sinanaj

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Nisin kualifikueset e Botërorit, si del Angli-Shqipëri?
20 Mars, 10:18
Fiton Anglia Barazim Fiton Shqipëria

Lajme të tjera

'Report TV' në shpellën e shkruar të Lepenicës ku fshihet historia 5 mijë vjeçare! Arkeologu: Piktogramet mund t'i shpëtojmë nëse shpallet monument kulture

Armand Xhelili

19 Mars, 15:46

Shpejtësi e lartë dhe parakalime të gabuara, Rrugorja në Vlorë: Mbi 1200 gjoba gjatë një jave, 9 shoferë të arrestuar

18 Mars, 14:50

Vlorë/ Bllokohet rruga Kuç-Qeparo, shkak erozioni i dherave dhe inerteve! Njoftohen ARRSH, nënkontraktori dhe Policia (VIDEO)

17 Mars, 15:32

Vlorë/ Keqtrajtoi foshnjën 5-muajshe duke e përplasur në trotuar, Policia: Nëna 37-vjeçare u mor nën akuzë, hetimet i ndjek Prokuroria

17 Mars, 12:16

E kishte kthyer lokalin në 'fole' prostitucioni, arrestohet administratorja dhe një 39-vjeçare (EMRI)

16 Mars, 13:46

Zjarr i madh në Tragjas të Vlorës, forca të zjarrfikëseve nisen drejt vendngjarjes! Flakët përfshijnë edhe malin e Gamit në Mukje! Vengu: Ishte i qëllimshëm (VIDEO)

15 Mars, 21:36

Vlorë, futbollisti nigerian i Flamurtarit u sulmua nga një person me probleme të shëndetit mendor

15 Mars, 15:53

Vlorë/ Piktura shkëmbore e Lepenicës shpallet në mbrojtje paraprake! Arkeologu: Një dëshmi e rrallë e artit prehistorik

15 Mars, 13:31

Kandidat për deputet i PS për Sarandën, mjeku që përfaqësON minoritetin grek Vasil Llajo: isha në dilemë prej muajsh, ja pse vendosa të garoj

15 Mars, 18:31

E rëndë në Vlorë, nëna e dehur përplas foshnjën 5 muajshe në tokë, shoqërohet në polici

14 Mars, 22:10

Vlorë/ Shoferi s'i bindet postbllokut të policisë, përplaset me makinën e Burgjeve dhe një tjetër! Dy efektivë të plagosur

14 Mars, 20:32

Vlorë, tentuan ta grabisnin plagoset me thikë 31-vjeçari futbollist i ekipit të Flamurtarit (EMRI)

14 Mars, 19:37

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje